



**Deklaratë për shtyp - 371/05/2020**

## **Qeveria e Republikës zgjeron investimet për ndihmën urgjente të NRW dhe për programin e ndihmës urgjente të MKW.**

**Ministri i Ekonomisë Pinkwart: Zgjidhja e pritshmërisë legjitime i ndihmon të vetëpunësuarit e vetëm në lehtësimin e pasojave të krizës**

**Ministrja e Kulturës Pfeiffer-Poensgen: Mbështetja për artistët e vetëpunësuar është rritur në 32 Milion Euro**

**Ministria e Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë, dhe Ministria e Kulturës dhe Shkencës ju informon:**

Qeveria e Republikës ka hartuar një zgjidhje të shpejtë e të drejtë të pritshmërisë legjitime në mënyrë që ndihma urgjente e NRW t'u mundësojë të gjitha bizneseve të vogla mbështetjen e pritur në krizën prej koronavirusit. Kjo ndodh sepse qëllimi i qeverisë së Republikës është që ndihma urgjente të përdoret vetëm për shpenzime materiale dhe financiare operacionale të vazhdueshme dhe jo për të mbuluar kosto bazë jetese. Për t'u siguruar që të vetëpunësuarit e vetëm, të cilët nuk kanë dorëzuar një aplikim për mbështetje të ardhurash bazë nuk pësojnë si rezultat disavantazh, qeveria e Republikës i mundëson atyre një subvencion indirekt prej 2.000 Euro për muajt mars dhe prill.

Rregulloret e zhvilluara për ndihmën urgjente të NRW vlejné gjithashtu për artistët e vetëpunësuar, të cilët nuk kanë dorëzuar aplikim deri në fund të prillit. Me fonde shtesë, të cilat arrijné në 27 Milionë Euro, mbështetja për artistët e vetëpunësuar do të zgjerohet:

Programi për ndihmën urgjente i krijuar nga Ministria e Kulturës dhe Shkencës në mes të marsit ka grumbulluar deri në 32 Milion Euro.

Deri në 13.000 punonjës artistikë të tjerë do të marrin një subvencion për të mbuluar kostot bazë të jetesës prej 2.000 Euro për muajt mars dhe prill.

Ministrja e Kulturës Isabel Pfeiffer-Poensgen: „Nëpërmjet vendimit të sotshëm ne si shtet kemi gjetur një zgjidhje të drejtë për shumë të artistë të vetëpunësuar të cilët janë veçanërisht të ndikuar nga kufizimet e koronavirusit.

Ishte një çështje me interes të veçantë për mua personalisht, që ne mos ta braktisim numrin e madh të punonjësve artistikë të cilët nuk janë përfshirë akoma në programin tonë të MKW. Prandaj po e rrisim programin deri në rreth 32 Milionë Euro dhe po ofrojmë njëkohësisht pritshmërinë legjitime si Republikë brenda hapësirës së ndihmës urgjente të NRW për ata aplikantë të cilët kanë aplikuar për ndihmën urgjente për të mbuluar kostot bazë të jetesës .“

Ministri i Ekonomisë Prof. Dr. Andreas Pinkwart: „Republikat e federatës e kanë nxitur qeverinë federale të garantojë se të vetëpunësuarit e vetëm, të cilët janë goditur rëndë nga kriza, mund të përdorin pjesë nga programi për ndihmën urgjente për të mbuluar kostot bazë të jetesës. Fatkeqësisht, qeveria federale nuk e ndoqi këtë kërkesë ndërpartiake të Republikave. Jam i lumtur që po i ndihmojmë të vetëpunësuarit për të lehtësuar pasojat e krizës nëpërmjet zgjidhjes së pritshmërisë legjitime të NRW. Kjo është në të njëjtën kohë një njohje e performancës sipërmarrëse dhe vlerësim i këtij grupi profesional.“

### **Përmbledhje e rregullave:**

- Të gjithë të vetëpunësuarit e vetëm duhet të dorëzojnë një deklaratë në fund të periudhës tre mujore të miratimit. Brenda saj ata deklarojnë nëse i nevojitej ndihma e plotë urgjente e NRW për të mbuluar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga koronavirusi. Përndryshe, ata duhet të paguajnë ndihmën e tepërt që kanë marrë. Rregullorja e vendosur tani përcakton se me këtë provë, ata mund të aplikojnë për 2.000 Euro për të mbuluar kostot bazë të jetesës.
- Kushti paraprak është që aplikantët të mos kenë aplikuar për ALG II në mars ose prill. Ky subvencion indirekt nga Republika nuk do të jepet as në rastin kur ata kanë marrë mbështetje nga programi urgjent i Ministrisë së Kulturës dhe Shkencës për artistët.

## **Programi i ndihmës urgjente për artistët e vetëpunësuar:**

- Aplikantët të cilët përmbushin kushtet , që kanë dorëzuar tashmë aplikimin por nuk janë pranuar ende për arsye të limitit të fondeve prej 5 Milionë Euro, do të përfitojnë një subvencion prej 2.000 Euro për mbulimin e kostove bazë të jetesës për muajt e prillit dhe të marsit nëse vërtetojnë aktivitetin e tyre artistik ( Anëtarësim tek Künstlersozial-kasse ose një shoqatë tjetër artistësh).  
Kushti paraprak është që ata të mos kenë marrë në prill ose mars benefite nga programi i MKW, ndihma urgjente e NRW 2020 ose të ardhura bazë.
- Mbështetja për ata aplikantë, aplikimet e të cilëve janë aprovuar tashmë do të rritet gjithashtu në një tarifë fikse prej 2.000 Euro.

Me ndihmën urgjente për koronavirusin, qeveria e Republikës ka arritur tashmë t'i japë mbështetje financiare dhe joburokratike më shumë se 400.000 kompanive që nga fillimi i programit në fund të marsit. Në total, qeveria e Republikës dhe ajo federale kanë paguar 4.07 Miliardë Euro. 86 përqind e aplikantëve ishin të vetëpunësuar dhe kompani me maksimumi 5 punonjës.

15.000 aplikime u refuzuan.

### **Kontakti për shtypin:**

Zëdhënësi për shtyp i MWIDE:

[Matthias.Kietzmann@mwide.nrw.de](mailto:Matthias.Kietzmann@mwide.nrw.de)

Zëdhënësi për shtyp i MKW: Jochen Mohr, 0211 / 896-4790,

[presse@mkw.nrw.de](mailto:presse@mkw.nrw.de)

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

***[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet social](#)***